



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA"
"Zija Shemsiu" pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

FORMULARI I VLERËSIMIT F2

(E plotëson Komisioni Vlerësues)

Fakulteti	Fakulteti i Edukimit
Lënda/ët për të cilat është shpallur konkursi	Histori e letërsisë kombëtare, Lexim dhe interpretim letrar, Edukatë estetike, Edukim dhe mediat, me plotësim norme në programin Master, Metodologji e kërkimit shkencor, Roli i mediave në qeverisjen lokale.
Thirrja për të cilën konkurron kandidati	Profesor Doktor, Prof. Dr.
Kandidatët e paraqitur:	1. Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi

Sqarim nga Komisioni vlerësues:

Komisioni vlerësues është bazuar në konkursin për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan, për vitin akademik 2020/2021, Ref.nr. 01/1742 dt.04/11/2020, ku në pikën 1. të konkursit nga Fakulteti i Edukimit kërkohet një mësimdhënës për lëndët: *Histori e letërsisë kombëtare, Lexim dhe interpretim letrar, Edukatë estetike, Edukim dhe mediat, me plotësim norme në programin Master, Metodologji e kërkimit shkencor, Roli i mediave në qeverisjen lokale.*

Komisionit i ka arritur vetëm një aplikacion, brenda afatit të përcaktuar kohor në konkurs, i cili i plotëson kushtet formalo-juridike për t'u trajtuar.

Komisioni, ka shqyrtuar aplikacionin, përkatësisht të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, vlerësimin për të cilin, duke u bazuar në nenin 233, pika 1, të Statutit të UKZ, si dhe në Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref.nr. 01/625/dt. 12/06/2020, e paraqet në këtë formular.

Komisioni vlerësues:

1. Prof. Dr. Sali Bashota, kryetar
2. Prof. Dr. Osman Gashi, anëtar
3. Prof. Dr. Ejup Ajdini, anëtar

I. TË DHËNAT PËR KANDIDATIN

Emri dhe mbiemri 1. BAJRAM KOSUMI

Tabela 1. Të dhënat për kandidatin /ët për të cilin shkruhet raporti/et

Emri dhe mbiemri	Bajram Kosumi
Ditëlindja dhe vendlindja	20.03.1960
Grada shkencore dhe viti kur është fituar	Doktor i Shkencave të Filologjisë; 2008
Titulli akademik (nëse është rizgjedhje)	Profesor i Asocuar, Prof. Asoc.
Viti kur është fituar titulli aktual (nëse është rizgjedhje)	2013
Universiteti/fakulteti/departamenti ku është fituar titulli akademik	Universiteti i Prishtinës Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gazetarisë
Arsimimi i lartë	
STUDIMET THEMELORE	
Institucioni	Universiteti i Prishtinës
Vendi	Prishtinë
Titulli i fituar	Profesor i letërsisë dhe gjuhës shqipe
Data / viti i diplomimit	1994
Fusha e studimit	Filologji
STUDIMET MASTER / MAGJISTRATURË	
Institucioni	Universiteti i Prishtinës
Vendi	Prishtinë
Titulli i fituar	Magjistër i Shkencave Filologjike, Mr. Sc.
Data / viti i diplomimit	2004
Fusha e studimit	Filologji
STUDIMET E DOKTORATËS	
Institucioni	Universiteti i Prishtinës
Vendi	Prishtinë
Titulli i fituar	Doktor i Shkencave Filologjike
Data / viti i diplomimit	2008
Fusha e studimit	Filologji
Profili	Letërsi Shqipe

Tabela 2. Të dhënat lidhur me gradën e fituar shkencore

Grada shkencore	Doktor i Shkencave Filologjike
Thirrja e fituar akademike	Profesor i Asocuar
Viti kur është fituar thirrja aktuale (vlen për rizgjedhje)	Prishtinë
Vendimi Ref.nr. 01/18 Dt. 12/01/2016	<u>2</u> / <u>963</u> Dt. 25/ <u>11</u> / <u>2013</u>
Universiteti / Fakulteti / Departamenti	Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gazetarisë
Nostrifikimi / MASHT/ NARIC	

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 2

Kandidati Bajram Kosumi është doktor i shkencave të filologjisë, ndërkaq ka thirrjen akademike profesor i asocuar, nga viti 2013. Thirrjen akademike profesor i asocuar (Prof. Asoc.) e ka marrë me vendimin Nr. Prot. 2/963, datë 25/11/2013, në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina". Aktualisht është rektor i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan dhe mësimdhënës i angazhuar në degën e Gazetarisë në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit "Hasan Prishtina" në Prishtinë.

1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor të kandidatit

Tabela 3. Monografitë

Nr.	Autori/ët	Titulli i publikimit	Fusha studimore	Recensentët	Shtëpia botuese, vendi, viti
1.	Bajram Kosumi	<i>Letërsia nga burgu/kapitull më vete në letërsinë shqipe</i>	Filologji	Dr. Behar Gjoka Emin Azemi	Instituti për Ruajtjen e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup. Shkup, 2020
2.	Bajram Kosumi	<i>Tipologji dhe zhanër</i>	Gazetari	Prof. Asoc. Dr. Millazim Krasniqi Prof. Ass. dr. Lindita Aliu	Olymp Prishtinë, 2013
3.	Bajram Kosumi	<i>Fishta dhe tradita letrare shqiptare (tezë doktrate)</i>	Filologji	Komisioni: Prof. Dr. Sabri Hamiti Prof. dr. Liman Matoshi Prof. asoc. Dr.Sali Bashota	Botim i dytë me ndryshime: Botimet Filozofia Urbane
4.	Bajram Kosumi	<i>Fishta dhe tradita letrare shqiptare (tezë doktrate)</i>	Filologji		Brezi '81. Prishtinë, 2012

					(financuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, 2011); www.librariaelektronike.com
5.	Bajram Kosumi	<i>Lirika e Fishtës</i>	Filologji	Tonin Cobani	Botimet TOENA Tiranë, 2006.
6.	Bajram Kosumi	<i>Letërsia nga burgu/kapitull më vete në letërsinë shqipe</i>	Filologji	Myrvete Dreshaj-Baliu Ismail Syla	Botimet TOENA, Tiranë, 2006.

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 3

Kandidati Bajram Kosumi, ndonëse është aktiv në studimet nga fusha e letërsisë dhe gazetarisë, deri tash ka botuar 6 libra monografikë nga këto dy fusha, në të cilat ka trajtuar çështje të rëndësishme, si për studiuesit e këtyre fushave ashtu edhe për lexuesit.

Në studimet e tij nga fusha e letërsisë është marrë me njërin prej poetëve tanë më të njohur – Gjergj Fishta. Duke e studiuar veprimtarinë e tij jo vetëm poetike, Kosumi ka hartuar tri monografi për këtë kolos të letrave shqipe. Monografia e Kosumit “Lirika e Fishtës”, që është një studim gjithëpërfshirës, në të vërtetë paraqet një arritje kulminante të analizës së poezisë lirike të njërit prej bardëve tanë të letërsisë, poetit kombëtar, tradicionalistit modern, siç shprehet autori i librit për të: Gjergj Fishta.

Monografia për lirikën e Fishtës paraqet një ndihmesë të madhe edhe për studiuesit e letërsisë shqipe, sepse është libri i parë, i cili në mënyrë shteruese është marrë me një segment të veçantë të veprës letrare të Fishtës, në këtë rast me lirikën e tij, pasi deri tash për Fishtën më shumë është folur e shkruar si për një poet që ka shkëlqyer në poezinë epike, më shumë është folur e përfolur apo është shkruar për aspekte jashtëletrare për veprën e tij, duke i dhënë atij dhe veprës së tij dimensione nga më të ndryshmet. Ndërkaq dy monografitë e tjera, paraqesin Fishtën në tërësinë e tij, përkatësisht paraqesin gjithë gamën letrare të Fishtës. Kosumi në këto monografi shkon përtej një studimi mbi veprimtarinë e letrare të një autori, sepse ai e vendos Fishtën bashkë dhe përballë gjithë traditës letrare shqiptare. Në fakt monografitë për veprimtarinë letrare të Gjergj Fishtës të kandidatit Kosumi janë monografitë më gjithëpërfshirëse që mund të hartohen për një autor të veçantë.

Kandidati Kosumi, po kështu ka hartuar dy monografi, lidhur me letërsinë nga burgu, me ç’rast ka hapur një temë shumë interesante për studiuesit, por veçanërisht për historianët e letërsisë. Në monografitë e tij për letërsinë nga burgu Kosumi merret edhe me përkufizimin kohor dhe vendor të kësaj letërsie. Në këtë aspekt Kosumi, mbase për shkak të disa fakteve letrare që i ka pasur në dorë, ka arritur të përkufizojë kohën e këtyre shkrimeve. Në këtë mënyrë ai pos që ka arritur t’i identifikojë autorët të cilët kanë pasur fatin të shkruajnë vepra letrare në burg, ka arritur t’i identifikojë edhe vlerat e tyre letrare, duke i tipizuar dhe lartësuar ato, bashkë me autorët e tyre. Po këtë tipizim të cilën Kosumi e karakterizon në rend të parë, si letërsia nga burgu, duke e argumentuar e shquar si entitet të veçantë të historisë së letërsisë shqipe. Argumentet e tij kryesore për këtë shquarje janë: koha dhe vendi i shkrimit të kësaj letërsie; rrethi letrar të cilit i kanë takuar autorët e kësaj letërsie.

Një monografi tjetër nga një fushë tjetër studimore e Kosumit është edhe monografia “Tipologji dhe zhanër”, e cila ka të bëjë kryesisht me tipologjinë dhe zhanret nga fusha mediatike. Monografitë e kandidatit Bajram Kosumi janë pritur mirë edhe nga lexuesit dhe studiuesit e letërsisë në

gjithë arealin gjuhësor shqiptar.

Kandidati Bajram Kosumi është autor edhe disa librave të tjera nga fusha të tjera studimore, si nga publicistika, por ai është edhe autor i disave librave poetikë. Bajram Kosumi ka shkruar edhe një serë recensionesh në gazeta, revista dhe në periodikë të ndryshëm. Është redaktor dhe recensentë i një morie veprash nga fusha e letërsisë, e publicistikës, por edhe nga fushat e tjera. Ka marrë pjesë në shumë ngjarje kulturore, qoftë me kumtesa nëpër konferenca të ndryshme apo me kumtesa në promovime dhe manifestime të ndryshme letrare dhe jo vetëm letrare.

Tabela 4. Tekstet mësimore

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues
1.	Bajram Kosumi	<i>Zhanret e gazetarisë</i>	Gazetari	Prof. Asoc. Dr. Milazim Krasniqi Arbër Vllahiu	Shtëpia Botuesi Artini, Botim i dytë, 2020
2.	Bajram Kosumi	<i>Zhanret e gazetarisë</i>	Gazetari	Prof. Asoc. Dr. Milazim Krasniqi Arbër Vllahiu	UBT, 2016

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 4

Kandidati bajram Kosumi, duke qenë për disa vite rresht dhe aktualisht, mësimdhënës në degën e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" ka hartuar tekstin mësimor "Zhanret e gazetarisë", i cili për shkak të pritjes ë mirë nga studentët, por edhe nga lexuesit e interesuar, është ribotuar me disa plotësime, katër vite pas botimit të parë. "Zhanret e gazetarisë" mbledh në vete gjithë tipologjinë e njërit prej profesioneve më të vështira – gazetarisë. Ndonëse inicialisht libri është një dedikim për studentët e gazetarisë, ai shkon përtej kësaj. Bëhet interesante edhe për studiuesit e gazetarisë por edhe për profilet e tjera profesionale të cilët duan të dinë më shumë për tipologjinë e gazetarisë.

Tabela 5. Punimet e publikuara në revistat ndërkombëtare shkencore, sipas UA – MASHT No. 01/2018 dhe Nenit 17, pika 1 të Rregullores, Nr.01/625 dt.12.06.2020 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues
1.	Bajram Kosumi	Developing online journalism in Kosovo and shifting to business, rather than information"	Romanian Journal of Journalism and Communication	Issue 2 (59), year XIV (XVIII), 2019, pages: 36-42	http://www.jurnalism-comunicare.eu/rjc/abstract_en.php?id=197
2.	Bajram Kosumi	"Allegory in Prison Letters: Art or Puzzle?"	Linguistics and Literature Studies	2017, Vol. 5(4), pp. 301 - 307	http://www.hrpub.org/journals/article_info.php?ai

			DOI: 10.13189/lis. 2017.050408		d=6173
3.	Bajram Kosumi (first Author)	"Partnership of Media with the Public" (first Author)	Acta Universitatis Danubius Communicati o	2017, Vol 11, no 1, pp 65-74	http://journals.univ-danubius.ro/index.php/communication/article/view/4090
4.	Bajram Kosumi (sec. Author)	The impact of Democracy in the Media and Public Opinion	Acta Universitatis Danubius. Communicati o	2017, Vol 11, No 2, pp 39-52	http://journals.univ-danubius.ro/index.php/communication/article/view/4372
5.	Bajram Kosumi	<u>Decentralization should not imply enclavization</u>	<u>Helsinki Monitor,</u> Brill <u>Academic Publishers</u> ISSN: 0925- 0972 E-ISSN: 1571- 814X	Volume 16, Issue 4, 2005, pp.: 319- 322	http://booksandjournals.brillonline.com/content/journals/10.1163/157181405775080966
6.	Bajram Kosumi (autor i dytë)	"Plagiarism in Kosovo and its perception in Kosovo and Albania Society."	Towards Consistency and Transparency in Academic Integrity edited by Salim Razi, Irene Glendinning and Tomáš Foltýnek. Peter Lang, 215.	https://doi.org/ 10.3726/b1527 3 Berlin 2018	https://www.pet erlang.com/abstr act/9783631781 593/xhtml/chapt er16.xhtml?rskey =6pjnyu&result= 1
7.	Bajram Kosumi	Il Kosova in Europa come state indipendente	Limes, rivista Italiana di geopolitica	Nr. 4, 2005, fq. 119-121	https://www.lim esonline.com/so mmari-rivista/i- balcani-non- sono-lontani-2

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 5

Kandidati Bajram Kosumi, ka botuar shtatë punime shkencore në revista të cilat janë në platformat e kërkua nga MASH për avancimin e mësimdhënësve në arsimin e lartë.

Gjashtë punime, nr. 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7 janë në përputhje me UA – MASHT No. 01/2018 dhe Nenit 17, pika 1 të Rregullores, Nr.01/625 dt.12.06.2020. Dy prej tyre, nr. 5 dhe 7, janë të fushës politike, një është “chapter book”, punimi nr. 6.

Prandaj merren për bazë punimet me nr: 1, 2, 3, 4.

Në aspektin profesional mund të themi se punimet e kandidatit paraqesin arritje larta dhe të shkëlqyera qoftë nga fusha e studimit të letërsisë, qoftë nga fusha e studimeve mediatike.

Vlen të theksohet se pesë nga shtatë punimet e paraqitura në tabelën e sipërme janë botuar pas marrjes së thirrjes profesor i asocuar (prof.. asoc.), pra pas vitit 2013.

Tabela 6. Punimet e publikuara në revistat ndërkombëtare shkencore, sipas UA – MASHT No. 01/2018 dhe Nenit 17, pika 2 të Rregullores, Nr.01/625 dt.12.06.2020 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues
1.	Bajram Kosumi	“Tjetri” në tekstet letrare të Fishtës	Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare	Nr. 35, fq. 657-668 2017	Neni 17. Prg.2.2 Punimi është i indeksuar në Microsoft Academic Research https://academic.microsoft.com/paper/3017477947/related

Diskutim/interpretim i të dhënave

Kandidati Bajram Kosumi ka paraqitur një punim në këtë pjesë, i cili është në përputhje me UA – MASHT No. 01/2018 dhe Nenit 17, pika 2 të Rregullores, Nr.01/625 dt.12.06.2020. Ky punim e plotëson pjesën më lart prej katër punimeve, duke u barasvlerësuar me 0.85 të pikës.

Tabela 7. Punimet e publikuara në revistat ndërkombëtare shkencore, sipas UA – MASHT No. 01/2018 dhe Nenit 17, pika 3 të Rregullores, Nr.01/625 dt.12.06.2020 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues
1.	Bajram Kosumi	“Konceptet estetike të Fishtës dhe tradita e mendimit estetik shqiptar”	Gjurmime albanologjike, seria e shkencave filologjike, Instituti Albanologjik i	Nr. 40/ 2010-2011, fq. 217-237.	Neni 17. Prg.3.6 Punimi është i indeksuar në CEEOL https://www.ceeoil.com/search/article-

			Prishtinës		detail?id=168366
2.	Bajram Kosumi	Letërsia si interpretim i kodeve të tjera	SYMBOL		Neni 17. Prg.3.6 Punimi është i indeksuar në CEEOL https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=607983

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 7

Kandidati Bajram Kosumi ka paraqitur dy punime, në përputhje me UA – MASHT No. 01/2018 dhe Neni 17, pika 3 të Rregullores, Nr.01/625 dt.12.06.2020. Këto dy punime e plotësojnë pjesën më lartë prej katër punimeve, duke u barasvlerësuar secili me 0.70 të pikës.

Tabela 8. Punimet e publikuara në revistat ndërkombëtare shkencore, sipas UA – MASHT No. 01/2018 dhe nenit 17, pika 4 të Rregullores, Nr.01/625 dt.12.06.2020 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues
1.	Bajram Kosumi	“Shkolla proklasike shkodrane”	Revista STUDIMI, [KUD 908 (496.51) 008(=18), Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës	Nr. 16-17, 2009/2010, fq. 305-325. KUD 821.18:821.18-97	Neni 17. Prg.4.2 http://ashak.org/repository/docs/PERMBAJTJA - STUDIME 16 - 17 438140.pdf

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 8

Kandidati Bajram Kosumi ka paraqitur një punim në këtë pjesë, i cili është në përputhje me UA – MASHT No. 01/2018 dhe Neni 17, pika 4 të Rregullores, Nr.01/625 dt.12.06.2020. Ky punim e plotëson pjesën më lartë të katër punimeve, duke u barasvlerësuar me 0.55 të pikës.

Tabela 9. Punimet e publikuara në revistat ndërkombëtare shkencore, sipas UA – MASHT No. 01/2018 dhe nenit 17, pika 5 të Rregullores, Nr.01/625 dt.12.06.2020 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues
1					

2					
3					

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 9

Kandidati Bajram Kosumi nuk ka paraqitur ndonjë punim në këtë pjesë që do të mund të trajtohej. Mirëpo, kjo pjesë është e plotësuar me pjesën më lart, ku janë paraqitur punimet e tij në platformat e kërkuara, sipas udhëzimeve të MASHT-it.

Tabela 10. Punimet e publikuara në revista rajonale (Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, B e H)

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues
1.	Bajram Kosumi	"Fishta intertekstual"	Albanology/ International Journal of Albanology ISSN 1857-9485 (print)	Nr 3- 4/2015, fq. 91-99	https://journals.indexpopernicus.com/search/details?id=51236
2.	Bajram Kosumi	"Habia dhe mospërcaktimi si elemente moderne në poezinë e Kasëm Trebeshinës"	Revista <i>Pasqyra e t'Rrëfyemit</i> , Qendra Shqiptare e Studimeve Letrare "Pjetër Budi", Tiranë, (ISSN: 2414-5580).	2016, viti II, nr. 4, fq. 85-90.	
3.	Bajram Kosumi		"Format e Atdheut në poezinë shqipe"	Revista ndërkombëtare <i>Diskutime</i> (ISSN print 1857-825X, ISSN online 1857-8543)	Nr. 9, 2013, fq. 607-613.
4.	Bajram Kosumi		"Arti si çelës midis jetës dhe vdekjes në letërsinë nga burgu"	Revista ndërkombëtare <i>Diskutime</i> (ISSN print 1857-825X, ISSN online 1857-8543)	Nr. 7, shtator 2013, fq. 78-88
5.	Bajram Kosumi		"Revolucioni i vitit 1981 në Kosovë / ndikimi i demonstratave të vitit 1981 në proceset e gjithëmbarshme	Revista ndërkombëtare <i>Diskutime</i> (ISSN 1857-825X)	Nëntor-dhjetor 2012, fq. 47-62.

			kombëtare dhe ndërkombëtare”		
6.	Bajram Kosumi		“L’anno 1981 e il movimento albanese per l’indipendenza”	<i>Rrënjët-Le Radici [Giornale indipendente], Rome, Italy.</i>	Anno 9, nr. 2, 3, 2011,

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 10

Kandidati Bajram Kosumi, në këtë pjesë ka paraqitur 6 punime të tij nga fusha e studimit të letërsisë, por edhe nga fusha e publicistikës, të cilat si të tilla paraqesin një mbështetje tjetër për avancimin e tij.

Tabela 11. Punimet e publikuara në revista kosovare

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues
1.	Bajram Kosumi	Kultura shtetformuese shqiptare në dekadën e dytë të shekullit XXI”	<i>Akademia-revistë për kulturë, gjuhë, media, Prishtinë</i>	2017, nr. 1, fq. 21-27	
2.	Bajram Kosumi	“Don-Quixotism of Poetry/ On the Courage of Ęriting Poetry at a Time of Rapacity”.	Revista <i>Thesis</i> , Prishtinë (ISSN: 1848-4298)	no. 3., 2015, fq. 95-102.	www.scholar.google.com
3.	Bajram Kosumi	“Nga gazetaria hulumtuese te gazetaria e kyçur”	<i>Media-revista kërkimore</i>	Nr. 5-6, 2013-2014, fq. 23-35.	
4.	Bajram Kosumi	“Letërsia si interpretim i kodeve te tjera”	<i>Symbol, revistë kulturore</i> ISSN 2310-9998	Nr. 3, 2014, fq. Fq. 108-113	
5.	Bajram Kosumi	“Letërsia nga burgu”	<i>Symbol, revistë kulturore</i> ISSN 2310-9998	Nr. 2, 2014, fq. 100-111.	
6.	Bajram Kosumi	“Gazetaria editorialiste / mediet në Kosovë: midis informimit dhe editorializmit”	<i>Media-revistë kërkimore, UP, Fakulteti Filologjik, Dega e Gazetarisë.</i>	Nr. 4, 2012, fq. 55-65 KDU 070(496.51)(048)	
7.	Bajram Kosumi	“Shkalla e zhanreve gazetares”	<i>Media-revistë kërkimore, UP, Fakulteti Filologjik, Dega</i>	Nr. 3, 2011, fq. 7-20. KDU 070.1	

			e Gazetarisë		
8.	Bajram Kosumi	“Tre poetë, tri figura dhe tri ligjërime”	<i>Educologia</i> , [KUD 37.5/2011], Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit	2011, fq. 75-79. KDU 821.18-09(083.77)	
9.	Bajram Kosumi	“Stili ligjërimit i reklamës në shtypin e Kosovës”	<i>Media- revistë kërkimore</i> , UP, Fakulteti Filologjik, Dega e Gazetarisë [autor i pare].	Nr. 2, 2010, fq. 81-90.	
10.	Bajram Kosumi	“Teori tipologjike e gazetarisë”	<i>Media- revistë kërkimore</i> , UP, Fakulteti Filologjik, Dega e Gazetarisë	Nr. 2, 2010, fq. 15-42.	
11.	Bajram Kosumi	“Leximi dhe shoqëria shqiptare”	<i>Jeta e Re</i> , Prishtinë	Nr. 3, 2010, fq. 468-473.	

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 11

Kandidati Bajram Kosumi, në këtë pjesë ka paraqitur 11 punime të tij nga fusha e studimit të letërsisë dhe të gazetarisë, si të tilla, pa përjashtim, janë edhe një mbështetje e fuqishme për avancimin e tij, sipas udhëzimit të MASHTI-t.

Po kështu, pesë nga punimet e paraqitura këtu janë botuar pas fitimit të thirrjes së fundit akademike, përkatësisht pas marrjes së thirrjes akademike profesor i asocuar.

Tabela 12. Prezantimet në konferenca

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumi etj.	Vëllimi, nr., faqet, viti
1.	Bajram Kosumi	“From local to global conflicts”	World Summit 2019 on “Peace, Security and Human Development”, Seoul, Korea.	February 7-11, 2019
2.	Bajram Kosumi & Dukagjin Leka	“Kosovo and its integration into the European Union”	Conference “The Balkans In The European Integration – Past, Present, Future” Sofia University St. Kliment Ohridski, Bulgaria.	16–17 May 2018
3.	Bajram Kosumi	“Letërsia dhe shteti/ Letërsia nga burgu”	Konferencë Shkencore Ndërkombëtare	15 dhjetor 2017

		përballë shtetit modern të shekullit XX”	“Letërsia si kujtesë”. Organizuar: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Letërsisë	
4.	Bajram Kosumi	Hyrje në temën “Marrëdhëniet e popullit shqiptar me Austro- Hungarinë nga mesi i shekullit XIX e deri në ditët tona”	Konferencën për “Marrëdhëniet e popullit shqiptar me Austro-Hungarinë nga mesi i shekullit XIX e deri në ditët tona” Organizuar: UP Prishtinë, UKZ Gjilan, Kolegji UBT, Instituti për Studime politike dhe Ndërkombëtare në Shkup, Shtëpia Botuese Logos A.	<i>Proceedings Book</i> 2017, fq. 7-9
5.	Bajram Kosumi	“Raporti i gazetarisë me të vërtetën. Mediat dhe ndryshimet shoqërore”	Konferenca Nderkombetare “Prishtina Media Days.” Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Vienës, SEEMO, Akademia Diplomatike e Kosovës. Instituti i Medias	<i>Prishtinë, 3-5 Maj 2017</i>
6.	Bajram Kosumi	“Dosja H. E Kadaresë: historia, metahistoria dhe parahistoria si sfond dhe diskursi si zemër e romanit”	Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Studia Kadareiana, Albanica et Humanitatis”; Organizuar: Universiteti i Tiranës	15 dhjetor 2016
7.	Bajram Kosumi	“Filozofia politike e kombëtare e Adem Demaçit”; kumtesë.	Konferenca Shkencore në 80-vjetorin e lindjes së Adem Demaçit, Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Shoqata e të Burgosurve Politikë, Prishtinë, Kosovë.	<i>Proceedings Book</i> 2016
8.	Bajram Kosumi	“Tjetri” në tekste letrare të Fishtës; kumtesë.	Universiteti i Prishtinës/Seminari i XXXV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën	<i>Proceedings Book</i> 2016, 35/2, fq. 101-111.

			Shqiptare, Prishtinë, Kosovë.	
9.	Bajram Kosumi	“Ligjërimi fetar në letërsinë dhe në publicistikën e Fishtës/ <i>Feja personale dhe feja letrare e Fishtës: Fe dhe Atme-Atme e Fe</i> ”; kumtesë.	Universiteti i Prishtinës/Seminari i XXXIV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, Kosovë.	<i>Proceedings Book</i> 2016, 35/2, fq. 439-451.
10.	Bajram Kosumi	“The Albanian Student Movement and Protests of 1981”; kumtesë.	The International Conference “25 Years Later: The Albanian Student Movement and Political Change in Albania, 1990-199”, Tirana, Albania.	December 12th, 2015.
11.	Bajram Kosumi	“Digital Media between reporting and doing business”	The First Conference on Communication and Media Studies “Media Industry: Trends, Dynamics and Challenges”, ICCMS, 26-27 march 2015, Tiranë, Shqipëri.	<i>Proceedings Book</i> http://beder.edu.al/static/docs/iccms_2015_final_c590.pdf
12.	Bajram Kosumi	“Letërsia si interpretim i kodeve të tjera”	Universiteti i Prishtinës/Seminari i XXXIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare / Prishtinë, Kosovë.	<i>Proceedings Book</i> 2014, 33/2, fq. 205-214
13.	Bajram Kosumi	“Arti si çelës midis jetës dhe vdekjes në letërsinë nga burgu”	Universiteti i Prishtinës, Seminari i XXXII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, Kosovë.	<i>Proceedings Book</i> 2013, , nr. 32/2, fq. 21-28.
14.	Bajram Kosumi	“Format e Atdheut në poezinë shqipe”	Universiteti Shtetëror i Tetovës, Konferencë Shkencore me temë: “Zhvillimet historike, politike-shoqërore, gjuhësore dhe kulturore të shqiptarëve, prej vitit 1912-2001”, Maqedoni.	<i>Proceedings Book</i> 1 nëntor 2012
15.	Bajram Kosumi	“Kapitulli i parë i historisë së letërsisë	Universiteti Shtetëror i Tetovës, Seminari	<i>Proceedings Book</i> 2012, 20-22 shtator, nr.

		shqiptare [Teza për përfshirjen e letërsisë gojore në historinë e letërsisë shqiptare dhe për leximin bashkëkohor të saj].”	Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë, Maqedoni	VI, fq. 68-76.
16.	Bajram Kosumi	“Historia e letërsisë midis faktografisë, didaktizmi dhe interpretimit kritik”	Universiteti i Prishtinës, Seminari i XXXI Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, Kosovë.	<i>Proceedings Book</i> 2012, nr. 31/2, fq. 17-26.
17.	Bajram Kosumi	“Revolucioni i vitit 1981 në Kosovë”	Universiteti Shtetëror i Tetovës, Seminari V Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë-Shkup, Maqedoni	<i>Proceedings Book</i> 3-4 Tetor 2011, nr. V, fq. 447-466.
18.	Bajram Kosumi	“Letërsia nga burgu/çështje të identifikimit, të përkufizimit dhe të trajtimit të saj”	Universiteti i Prishtinës, Seminari i XXX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, Kosovë. Ligjëratë	<i>Proceedings Book</i> 2011, 30/1, 2011, fq. 19-40.
19.	Bajram Kosumi	“Kontrolli i komunikimit gazetar [rasti i Kosovës]”	Universiteti Shtetëror i Tetovës, Seminari Ndërkombëtar i Albanologjisë, Maqedoni	<i>Proceedings Book</i> 2010, 12-14 tetor, nr. IV, fq. 179-186.
20.	Bajram Kosumi	“Poezia nga burgu”	Universiteti i Prishtinës, Seminari i XXIX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, Kosovë.	<i>Proceedings Book</i> 2010, nr. 29/2, fq. 225-233.
21.	Bajram Kosumi	“Revolucioni i vitit 1981 dhe ndikimi i tij në socializmin botëror”	Instituti Albanologjik, Shoqata e të Burgosurve Politikë, Konferencë shkencore ndërkombëtare, Prishtinë, Kosovë.	2011
22.	Bajram Kosumi	“Teksti narrativ dhe teksti refleksiv në kulturën shqiptare”	Tryezë me lexuesit: “Bajram Kosumi: njeriu, vepra dhe intelektual”, organizuar nga Qendra Shqiptare e Studimeve të Letërsisë “Pjetër	5 dhjetor 2015, Tiranë.

			Budi", Tiranë, Shqipëri.	
23.	Bajram Kosumi	"Politika midis faktorëve realë e fiktivë"	Ligjëratë në Shkollën e Liderëve të rinj në Shkup, Maqedoni.	11 maj 2012
24.	Bajram Kosumi	"Leximi si faktor kulturor dhe si faktor ekzistencial"	Ligjëratë me shkrimtarët e Vlorës në organizim të Shoqatës Kulturore Think, Vlorë, Shqipëri.	13 gusht 2010
25.	Bajram Kosumi	"Kosovo and the Final Status Process"	Ligjëratë në Columbia University, Columbia Laë Scool, Neë York, USA.	February 13, 2006.
26.	Bajram Kosumi	"Kosovo and the Final Status Talks"	Ligjëratë në Chatham House, London, UK.	December 8, 2005
27.	Bajram Kosumi	"Proceset politike në Kosovë"	Ligjëratë në Stiftung fur Èissenschaft und Politik, Berlin, Germany.	July 12, 2005.
28.	Bajram Kosumi	"Kosova në proceset Politike"	Ligjëratë në Regional Conference "Southeast Europe on the Èay into the European Union", held by the Bertelsmann Stiftung, Zagreb, Croatia.	June 3-4, 2005

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 12

Kandidati Bajram Kosumi, në këtë pjesë ka paraqitur pjesëmarrjen e tij në 28 konferenca shkencore mjaft të rëndësishme, nga fusha e studimit të letërsisë, por edhe të fushave të tjera si gazetaria, publicistika por edhe politikologjia.

Vlen të theksohet se kandidati Bajram Kosumi, është aktiv me pjesëmarrjen e tij në konferenca të ndryshme shkencore. Ndërkaq, punimet e tij, sikurse edhe paraqitjet e tij debatuese, gjithnjë janë pritur mirë dhe kanë zgjuar vëmendjen tek auditoriumi.

Tabela 13. Kontribute tjera shkencore dhe profesionale

Parathënie për libra, ese në fushë të gazetarisë e të letërsisë

Nr.	Autoret	Lloji i kontributit shkencor	Botuesi	Vendi/ Viti
1.	Bajram Kosumi	"Libri i epëve të kotësisë"-një interpretim i poezisë së Ismail Sylës"	Mediat ditore, të shkruara dhe digjitale	18 dhjetor 2015
2.	Bajram Kosumi	"Gilbushi dhe Fati: a është kjo një antitezë?", parathënie për librin me poezi të Merxhan Avdyllit <i>Antologji egoiste</i> .	Embata, Prishtinë	Fq. 7-14, 2015

3.	Bajram Kosumi	"Drejt tempullit të babëzisë", pasthënie për librin me poezi të Ismail Sylës <i>Religjioni i pikëllimit</i> .	Brezi '81, Prishtinë	fq. 131-141, 2015
4.	Bajram Kosumi	"Atdhe dhe fe/libri me intervista i Myftiut Naim Tërnavë", parathënie për librin <i>Ligjërime për fenë e atdheun/pikëpamje, qëndrime dhe mendime të Naim Tërnavës</i> .	KBI Republikës së Kosovës, 2015	Fq. 9-23 (shqip) Fq. 25-39 (angl)
5.	Bajram Kosumi	"1 Tetori i shikuar ga Brenda", pasthënie në librin 1 Tetori I kthesës	Universiteti Prishtinës,	fq. 535-540, 2013
6.	Bajram Kosumi	"Një histori që vazhdon të ndodhë: partitë politike shqiptare në Maqedoni", parathënie në librin e Emërllah Ukshinit <i>Demokracia brendapartiake/Struktura e partive politike shqiptare ne Maqedoni</i>	Brezi '81, Prishtinë	fq. 5-10, 2013
7.	Bajram Kosumi	"Nga socializmi deri te kapitalizmi", parathënie në librin e Jonuz Jonuzajt, <i>Shqipëria ime/unë dhe Ramiz Alia</i>	Toena, Tiranë	fq. 5-12, 2012.
8.	Bajram Kosumi	"Bajram Kosumi për librin <i>Adem Demaçi/biografi</i> të autorit Shkëlzen Gashi"	http://www.gazetashtepaqe.com/gazeta/shkelzen_gashi.html	2010
9.	Bajram Kosumi	"Shtypi i lirë, provues dhe nismëtar i demokracisë", recension për librin <i>Shtypi i lirë dhe demokratizimi i shoqërisë</i> , të Mr. Blerim Burjanit	Gazeta 24 Orë	nr. 13, 21 dhjetor 2002
10.	Bajram Kosumi	"Përmasa e katërt e botës", pasthënie në librin <i>Duke kërkuar esencat të Ismail Sylës</i> "	Gazeta Rilindja botuar edhe te <i>Koha Ditore</i>	fq. 169-177, 1997 korrik 1997
11.	Bajram Kosumi	"Libri i fitores mbi të keqen", parathënie në librin <i>Letra nga burgu / Libri i censuruar</i> , përgatitur nga M. Avdyli e B. Kosumi,	Brezi 81, Prishtinë [ISBN 9951 424 04 X]	fq. 7-21, 2004
12.	Bajram Kosumi	"Letërsia nga burgu-sprovë për njohje"	Gazeta Koha Ditore	1 e 2 maj, 2004
13.	Bajram Kosumi	"Jetë në kërkim", pasthënie për poezinë e Merxhan Avdylit, në librin e tij <i>Fati i flijuar</i>	Revista Fjala	fq. 91-98, 1994
14.	Bajram Kosumi	"Fjalor i kuptimeve poetike të Ismail Sylës"	Gazeta Koha Ditore	18 prill, 2000.

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 13

Në tabelën e mësipërme kandidati Bajram Kosumi ka paraqitur 14 kontribute të tjera shkencore dhe profesionale, të cilat vetëm sa e përplotësojnë kandidatin, i cili ka aplikuar për thirrje më të avancuar akademike.

Po kështu, duke qenë i plotësuar kandidati Bajram Kosumi, vlen të theksohet se të gjitha kontributet e tij shkencore dhe profesionale janë të dëshmuara në aplikacionin e tij.

2. Përvoja universitare

Tabela 14. Përvoja në mësimdhënie universitare

Periudha e angazhimit (vitet akademike)	Grada shkencore dhe Thirrja akademike		Institucioni, Vendi	Programi i studimit	Ligjërues i lëndëve	Vërejtje
2008-2012	Dr. Sc. Prof. Ass.		Universiteti i Prishtinës Prishtinë	Gazetari	Zhanret gazetare Editoriali, komenti dhe analiza Stilistika Kritika mediale	
2012- në vijim	Dr. Sc. Prof. Asoc.		Universiteti i Prishtinës Prishtinë	Gazetari	Zhanret gazetare Editoriali, komenti dhe analiza Bazat e stilit gazetar Stilistika Kritika mediale	
2010-2015	Dr. Sc. Prof. ass. Prof. asoc.		Universiteti Shtetëror i Tetovës	Gazetari	Zhanret mediatike Debati publik	
2011-2015			Kolegji UBT	Gazetari	Zhanret e gazetarisë Shkrimi ligjor	
2017-në vijim	Dr. Sc. Prof. Asoc.		UKZ	QLSHD	Metodat e kërkimit shkencor Mediet dhe qeverisja lokale	

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 14

Kandidati Bajramn Kosumi ka një përvojë të gjatë në arsimin e lartë. Ai ka qenë një kohë mësimdhënës i rregullt në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", ndërkaq aktualisht është rektor, në mandatin e dytë në Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan. Po kështu është edhe mësimdhënës i angazhuar në degën e Gazetarisë të Fakultetit të Filologjisë, të Universitetit "Hasan Prishtina" në Prishtinë, ndërkaq në UKZ mban ligjërata me studentët e masterit, lëndë nga fusha mediatike dhe e metodologjisë shkencore.

Duke u bazuar në përvojën e tij në arsimin e lartë, si dhe në performancën e tij të treguar në Fakultetin e Filologjisë, në Universitetin "Hasan Prishtina" të Prishtinës, si dhe në mësimdhënie në UKZ, mund të konstatojmë se kandidati Bajram Kosumi në tërësi i plotëson kushtet për avancim e tij nga **profesor i asocuar (prof. asoc.)** në **profesor doktor (prof. dr.)**.

Tabela 15. Udhëheqje të temave master dhe të doktoratës

Periudha e mentorimit	Institucioni, Vendi	Mentorime në studimet Master	Mentorime në studimet e doktoratës	Vërejtje

2016-2020	Universiteti i Prishtinës Programi i doktoratës: <i>Gazetari dhe Shkencat e Komunikimit</i> Mentor		Kand. Faton Ismajli: <i>"Transformimi i zhanrit në mediet online"</i> .	<i>Mbrojtur: 2020</i>
2020	Universiteti i Prishtinës Programi i doktoratës: <i>Gazetari dhe Shkencat e Komunikimit</i> Kryetar i Komisionit për vlerësim dhe mbrojtje		Kand. Dren Gërguri: <i>"Komunikimi politik në mediet sociale në zgjedhjet e përgjithshme 2017 në Kosovë"</i>	
2020	Universiteti i Prishtinës Programi i doktoratës: <i>Gazetari dhe Shkencat e Komunikimit</i> Kryetar i Komisionit për vlerësim dhe mbrojtje		Kand. Alban Zeneli, <i>"Raporti ndërmjet medieve të reja dhe atyre tradicionale në Kosovë (gazeta, radio dhe televizioni përballë portaleve dhe rrjeteve sociale)"</i>	
2018	Universiteti i Prishtinës Programi i doktoratës: <i>Gazetari dhe Shkencat e Komunikimit.</i> Kryetar i Komisionit për vlerësim mbrojtje		Kand. Muhamet Jahiri, <i>"Analizë kritike e raportimit të gazetave ditore shqipe për trazirat e marsit 2004"</i>	
2018	Universiteti i Prishtinës Programi i doktoratës: <i>Gazetari dhe Shkencat e Komunikimit.</i> Kryetar i Komisionit për vlerësim mbrojtje.		Kand. Arben Fetoshi, <i>"Roli i medieve në procesin e integritetit evropian (rasti i Kosovës)"</i>	

	Universiteti i Prishtinës Programi i doktoratës: <i>Letërsi shqipe</i> . Anëtar i Komisionit për vlerësim dhe mbrojtje		Kand. Afërdita Haliti, " <i>Proza e autoreve bashkëkohore shqiptare</i> "	
2019	Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë. <i>Programi Letërsi Shqipe</i> Anëtar i Komisionit për vlerësim dhe mbrojtje		Kand. Rrok Gjolaj, " <i>Zhvillimi i letërsisë shqipe në Mal të Zi/ Trajtesa: Nga tradita biblike deri më sot</i> ",	
	Universiteti i Prishtinës Programi i doktoratës: <i>Letërsi shqipe</i> . Anëtar i Komisionit për vlerësim dhe mbrojtje		Kand. Marjela Progni, " <i>Poezia erotike e romantizmit dhe e modernitetit</i> "	
	Universiteti i Prishtinës Programi i doktoratës: <i>Letërsi shqipe</i> . Anëtar i Komisionit për vlerësim dhe mbrojtje		Kand. Gjyle Totaj, " <i>Proza e Fatos Kongolit</i> "	
2019	Universiteti i Prishtinës, <i>Master: Gazetari dhe Kontakt me Publikun</i> Mentor	Kand. Mevlyde Hyseni, " <i>Infotajment: informim apo argëtim në edicionet e lajmeve televizive në Kosovë</i> ".		
2019	Universiteti i Prishtinës, <i>Master: Gazetari dhe Kontakt me Publikun,</i> Mentor	Kand. Egzona Mehmeti, " <i>Lajmi i portaleve informative përballë lajmit tradicional</i> ".		
2018	Universiteti i Prishtinës, <i>Master: Gazetari</i>	Kand. Donika Ahmeti, " <i>Diskursi i partive politike në fushatën zgjedhore për</i>		

	<i>dhe Kontakt me Publikun,</i> Mentor	<i>zgjedhjet parlamentare në Kosovë në vitin 2017”.</i>		
2017	Universiteti i Prishtinës, <i>Master: Gazetari dhe Kontakt me Publikun,</i> Mentor	Kand. Blerta Blakaj, <i>“Gazetaria dhe diskursi i politikanëve”.</i>		
2015	Universiteti i Prishtinës, <i>Master: Gazetari dhe Kontakt me Publikun</i> Mentor	Kand. Arlinda Guri, <i>“Ligjërimi i Rilindjes në vitin 1981”.</i>		
2013	Universiteti i Prishtinës, <i>Master: Gazetari dhe Kontakt me Publikun</i> Mentor	Kand. Faton Ismajli, <i>“Komentimi, përshkrimi dhe narracioni në tekstin gazetar”.</i>		
2012	Universiteti i Prishtinës, <i>Master: Gazetari dhe Kontakt me Publikun</i> Mentor	Kand. Musa Sabedini, <i>“Ligjërimi gazetar në periudha të jashtëzakonshme- rasti i ngjarjeve të viti 2004 në Kosovë”.</i>		

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 15

Sipas asaj që ka paraqitur të dokumentuar në aplikacionin e tij, kandidati Bajram Kosumi, deri tash, në studimet e doktoratës në gazetari ka qenë mentor i një kandidati, i cili e ka mbrojtur me sukses tezën e doktoratës (në UP), ndërkaq te pesë kandidatë të tjerë ka qenë anëtar ose kryetar i komisionit. Po kështu, në studimet master të gazetarisë, deri tash ka qenë mentor i gjashtë kandidatëve, të cilët i kanë mbrojtur me sukses temat e tyre (të gjithë në UP). Gjithashtu, kandidati Bajram Kosumi ka qenë anëtar komisioni edhe në studimet e doktoratës nga fusha e letërsisë te tre kandidatë, të cilët gjithashtu kanë mbrojtur me sukses tezat e tyre (një në Universitetit Shtetëror të Tiranës dhe dy në UP).

Tabela 16. Pjesëmarrja e dëshmuar në programe ose projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme

Nr.	Programi/ projekti shkencor	Periudha kohore	Institucioni, Vendi	Pozita ne program, projekt/ Kontribut
1.	Projekti Erasmus + QATEK	2020-2023	Koordinator, Universiteti “Hasan Prishtina” Prishtinë	Menaxher i Projektit
2.	Projekti Erasmus+ QUADIC	2020-2023	Koordinator Universiteti	Anëtar i Këshillit

			"Kadri Zeka" Gjilan	Drejtues (Steering Committee member)
3.	Projekti Erasmus + ResearchCult	2020-2023	Koordinator IBC-M, Mitorvicë	Anëtar i Bordit Implementues të Projektit
4.	Projekti Erasmus + ENEMLOS	2020-2023	Universiteti i Podgoricës, Mali i Zi	Anëtar i Këshillit Drejtues (Steering Committee member)
5.	Projekti Erasmus + e-VIVA	2018-2021	Universiteti Evropian i Tiranës, Shqipëri	Anëtar i Këshillit Drejtues (Steering Committee member)
6.	Projekti Erasmus + SMAHPC	2018-2021	Kolegji Heimerer, Prishtinë	Anëtar i Këshillit Drejtues (Steering Committee member)

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 14

Kandidati Bajram Kosumi është aktiv edhe në projekte të ndryshme, ndërkaq këtu e ka paraqitur pjesëmarrjen e tij në 6 projekte, në njërin prej të cilëve, sipas dokumentacionit në aplikacion është edhe menaxher i projektit, ndërkaq tek pesë projektet e tjera është anëtar i këshillave drejtues.

II. PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI
(THIRRJA AKADEMIKE E CILA PROPOZOHEJ)
(Të plotësohet nga komisioni)

Komisioni vlerësues, i formuar me Vendimin e Senatit të Universitetit publik “Kadri Zeka” në Gjilan, Ref.nr. 01/2426/22/12/2020, duke u bazuar në nenin 155 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit Publik “Kadri Zeka” Gjilan, Rregullores për zgjedhjen e personelit akademik Ref.nr.01/625 dt. 12/06/2020 dhe Konkursit për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të Universitetit Publik “Kadri Zeka” Ref.nr. 01/1742 dt.04/11/2020, për vitin akademik 2020/2021, pas shqyrtimit të dosjeve të kandidatëve, për pozitën një mësues për lëndët:

Histori e letërsisë kombëtare, Lexim dhe interpretim letrar, Edukatë estetike, Edukim dhe mediat, me plotësim norme në programin Master, Metodologji e kërkimit shkencor, Roli i mediave në qeverisjen lokale.

PROPOZON

Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi për thirrjen akademike **Profesor Doktor (Prof. Dr.)** në Fakultetin e Edukimit, në Universitetin Publik “Kadri Zeka” në Gjilan.

Komisioni erdhi deri te ky propozim duke pasur për bazë se kandidati **Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi** i plotëson të gjitha kushtet e parapara në Statutin, Rregulloren për zgjedhjen e personelit akademik, si dhe Konkursin e shpallur të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan.


Kandidati ka gradën e doktorit të shkencës (Dr.Sc./PhD) dhe thirrjen akademike të Profesorit të Asocuar (Prof. Asoc.) të fituar në bazë të Vendimit Nr. Prot. 2/963, datë 25/11/2013, të Universitetit Hasan Prishtina” në Prishtinë.

Nënshkrimet origjinale nga anëtarët e Komisionit vlerësues:

Prof. Dr. Sali Bashota, kryetar

Prof. Dr. Osman Gashi, anëtar

Prof. Dr. Ejup Ajdini, anëtar



Gjilan, më 6 janar 2021